

Deri te:

**KËSHILLI MËSIMOR SHKENCOR
I FAKULTETIT PEDAGOGJIK**

Në pajtim me nenet 110 dhe 173 të Ligjit të Arsimit të Lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 82/2018), neni 158 i Statutit të Universitetit të Tetovës dhe në përputhje me Rregulloren dhe kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhjen në tituj mësimor-shkencorë, shkencorë, mësimor-profesionalë dhe bashkëpunëtorë në Universitetin e Tetovës, në lidhje me konkursin për zgjedhje-rizgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha vendet shkencore-mësimore të Universitetit të Tetovës të publikuar më 24.06.2025 në gazetën ditore "Koha" dhe "Sloboden Peçat", si dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, për zgjedhjen e mësimdhënësit në fushën e Edukimit Special dhe Rehabilitimit (5.03.00.10) nga klasifikimi i fushave, zonave dhe disiplinave shkencore-hulumtuese sipas klasifikimit ndërkombëtar Fraskati, Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Pedagogjik, në mbledhjen e mbajtur më 09.07.2025, mori vendim për formimin e Komisionit të Recensentëve me nr. 24-853/1, në përbërje:

1. Prof. Dr. Bunjamin Memedi (kryetar) – profesor ordinar,
2. Prof. Dr. Lulzim Mehmedi (anëtar) – profesor inordinar në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Tetovës,
3. Prof. Dr. Arita Agai (anëtare) – profesor inordinar në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Tetovës.

Duke shprehur faleminderim për besimin e dhënë, Komisioni i Recensentëve dorëzon këtë:

REFERAT

PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE SHKENCORE NË FUSHËN E EDUKIMIT DHE REHABILITIMIT SPECIAL (5.03.00.10) NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT NË FAKULTETIN PEDAGOGJIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS, NË PROGRAMIN STUDIMOR EDUKIM DHE REHABILITIM SPECIAL NË FAKULTETIN PEDAGOGJIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS.

Në konkursin e shpallur në gazetën ditore "Koha" dhe "Sloboden Peçat" më 24.06.2025, si dhe në faqen zyrtare të internetit të Universitetit www.unite.edu.mk, për zgjedhjen/rizgjedhjen e mësimeve në të gjitha konkurset mësimore-shkencore nga fusha e Edukimit dhe Rehabilitimit Special (5.03.00.10), sipas klasifikimit të fushave, disiplinave dhe nën-disiplinave kërkimore-shkencore sipas Klasifikimit Ndërkombëtar Fraskati, është paraqitur vetëm kandidatja doc. dr. Jasmina Troshanska. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe të dhënat e tjera të kandidatës, Komisioni recensues jep konstatimet dhe vlerësimet në vijim:

1. Të dhënat biografike të kandidatit:

Kandidatja Dr. Jasmina Troshanska ka lindur më 22 Tetor 1979 në Shkup. Arsimin fillor e ka përfunduar në Shkup në vitin 1994, ndërsa arsimin e mesëm e ka përfunduar në vitin 1998 në shkollën e mesme mjekësore "Dr. Pançe Karagjov" në Shkup dhe është diplomuar si laborant-teknik mjekësor.

Arsimin e lartë e ka kryer në Institutin për edukim dhe rehabilitim special, në Fakultetin Filozofik pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup në vitin 2003, dhe në vitin 2004 fillon të punojë në projektin e UNICEF-it "Deinstitucionalizimi i personave me aftësi të kufizuara nga institucioni special në Demir Kapi". Në nëntor të vitit 2004 punësohet në SHFMU "Idnina", ndërsa në vitin 2006 punësohet në SHFMU "Dr. Zlatan Sremec" në paralelet speciale për autizëm.

Në vitin akademik 2005/2006 regjistrohet në studimet e magistraturës në Fakultetin Filozofik, programi studimor – Edukim dhe Rehabilitim Special – drejtimi Retardim

Mendor dhe Autizëm, pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, ku më 02.06.2009 e mbrojti temën me titull “Qëndrimet, mendimet dhe përvojat për trajtimin e personave me autizëm në Maqedoni” nën mentorimin e prof. dr. Vladimir Trajkovski. Dëshira për zhvillim profesional vazhdon më tej. Gjatë periudhës nga 09.09.2005 deri më 13.06.2007 ajo ndjek edukim intensiv për pedagogjinë Montessori dhe fiton diplomë ndërkombëtare për pedagog Montessori për fëmijë të moshës 3-6 vjeç. Aftësimi i saj profesional dhe interesimi i vazhdueshëm shkencor për edukimin dhe rehabilitimin special kulmon më 12.12.2016, kur me sukses e mbron disertacionin e doktoraturës me temë “Problemet në procesimin dhe integrimin e ndjesive shqisore te fëmijët me autizëm” nën mentorimin e prof. dr. Vladimir Trajkovski, në Fakultetin Filozofik në Shkup, në Institutin për Edukim dhe Rehabilitim Special, pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, ku fiton titullin Doktor i Shkencave të Defektologjisë. Kandidatja flet maqedonisht, anglisht, shqip, bullgarisht, serbisht, sllovenisht dhe gjuhë të tjera ish-jugosllave. Bazuar në të dhënat e dorëzuara përmes aplikimit për konkurs, komisioni e merr parasysh aktivitetin e saj të përgjithshëm, duke e theksuar dhe vlerësuar kontributin e saj pas emërimit në pozitën mësimore.

ARRITJET SHKENCORE, PROFESIONALE, PEDAGOGJIKE DHE TË TJERA TË KANDIDATES NGA ZGJEDHJA E FUNDIT DERI NË DITËN E APLIKIMIT

1. VEPRIMTARIA MËSIMORE-EDUKATIVE:

Doc. Dr. Jasmina Troshanska, pas emërimit të saj si docent më 29.12.2020, ishte e angazhuar në realizimin e ligjëratave, ushtrimeve dhe mësimit praktik në ciklin e parë të studimeve në lëndët: Spektri i autizmit, Metodika e punës me persona me çrregullime motorike, Metodika e punës me nxënës me dëmtime të shikimit, Riedukimi psikomotor, Teknologjia ndihmëse, Hyrje në edukimin e nxënësve me dëmtime të shikimit, Hyrje në edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale, Metodika e punës me persona me aftësi të kufizuara të lehta intelektuale, Ndërhyrja e hershme për persona me çrregullime nga spektri i autizmit, Puna edukativo-arsimore në internate dhe Terapia kreative.

Në ciklin e dytë të studimeve, ajo ishte e angazhuar në realizimin e lëndëve: Arsimi gjithëpërfshirës për nxënësit me çrregullime nga spektri i autizmit, Strategji gjithëpërfshirëse për çrregullime nga spektri i autizmit, Krijimi i programeve për punë me fëmijë me çrregullime nga spektri i autizmit dhe Krijimi i programeve për punë me adoleshentë dhe të rritur me çrregullime nga spektri i autizmit.

Doc. Jasmina Troshanska ishte e përfshirë në shumë aktivitete të drejtuara drejt zhvillimit të kompetencave të edukatorëve dhe rehabilituesve special, mësimdhënësve dhe edukatorëve përmes trajnimeve të organizuara në kuadër të projekteve në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

1.1. Trajnime:

- “Përballja me sjelljen e fëmijëve me autizëm në çerdhe” (2021–2022)
- Ndjesitë të fëmijët me autizëm (2022–2023)
- “Integrimi dhe mbështetja e nxënësve me autizëm në arsimin e rregullt” (2022)
- “Përballja me sfidat e autizmit në situata të paparashikuara” (2022)
- “Përfshirja përmes tregut të punës e personave me autizëm” (2023)
- “Trajnimi i mësuesve të edukimit fizik dhe shëndetësor për të punuar me nxënës me autizëm” (2023)
- “Trajnimi i prindërve të fëmijëve me autizëm për përdorimin e procedurave të ndërveprimit përmes mjeteve digjitale për të mësuar aftësi sociale të fëmijët me autizëm” (2023)
- “Trajnime STEAM për fëmijët me autizëm” (2024)
- “Përgatitja për shkollë e fëmijëve me autizëm përmes një programi të bazuar në parimet ABA” (2025)
- “Përballja me sjelljen e fëmijëve të moshës parashkollore” (2025)

1.2 Konsulent për:

- Hartimi i ligjit për arsimin e mesëm; për arsimin dhe trajnimin profesional dhe për arsimin e të rriturve, si dhe ligjet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin fillor gjatë vitit 2024.
- Mekanizmi kombëtar i monitorimit për ndjekjen e zbatimit të Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

1.3 Realizues i punëtorive:

- “Adaptimi i nxënësve me autizëm në arsimin gjithëpërfshirës – Mësimi social dhe emocional në fëmijërinë e hershme” (Janar 2023 – Qershor 2023), i mbështetur nga Ministria për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive.
- “Aspektet specifike të komunikimit me nxënësit” – Java e veçantë studimore, kërkimore dhe shkencore 2022.
- “Nxitja dhe zhvillimi i aftësive sociale tek fëmijët me autizëm” (Qershor 2023 – Dhjetor 2023) – i mbështetur nga Qyteti i Shkupit.
- “Mbështetje individuale për fëmijët me autizëm” për profesionistët e angazhuar në Qendrën për zhvillim të hershëm të fëmijëve dhe mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara “MoPi” (Korrik 2022).

1.1.1.4 Udhëheqëse e studentëve në ciklin e parë dhe dytë të studimeve / anëtare e komisionit për vlerësim të punimeve të diplomës apo tezës së magjistraturës.

Gjatë angazhimit të saj pedagogjik, kandidatja ka zhvilluar një bashkëpunim të ngushtë me studentët, duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave të tyre profesionale. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, që nga emërimi i saj i fundit, doc. prof. Jasmina Troshanska ka qenë mentore e:

- 9 studentëve dhe anëtare në 14 komisione për mbrojtje të temave të diplomës
- 2 tema të ciklit të dytë dhe ka marrë pjesë në 8 komisione për vlerësimin e tezave të magjistraturës. Aktualisht është mentore e 4 studentëve të ciklit të dytë.

1.5 Kandidatja është autore e udhëzuesve:

- Водич за практична примена на аугментативната и алтернативната комуникација во основното образование, Здружение за асистивна технологија „Отворете ги прозорците“, Скопје 2023.
- Udhëzues për zbatimin praktik të komunikimit augmentativ dhe alternativ në arsimin fillor, Shoqata për teknologji asistive ”Hapni dritaret”, Shkup, 2023.

1.6 Bashkautore e një udhëzuesi të botuar në kuadër ndërkombëtar në gjuhën angleze

- Trelova, I., Sweeney, C., Kozarova, J., Jancec, M., Troshanska, J., Faka, A., Sweeney, R. (2024). Behaviour management for children with autism, Teacher’s Handbook. University of Preshov, Preshov Press, 2024, ISBN 978-80-555-3326-1.

1.7 Përgatitja e materialeve për përdorim të brendshëm nga ligjëratat, dhe atë:

- Terapia kreative
- Riedukimi i psikomotorikës
- Intervenimi i hershëm dhe zhvillimi i fëmijëve me çrregullime të spektrit të autizimit

1.8 Recensente e librave:

- Ruxandra Foloștină, Clare Gartland, Albina Khasanzyanova, and Ümit Çelen. *Partnering with Student Ambassadors to Create More Inclusive Universities Best Practices for Collaboration*, Routledge, ISBN: 978-1-032-95008-2 (hbk)

Në bazë të Rregullores për kushtet dhe procedurën e veçantë për zgjedhje në titujt mësimor-shkencorë, shkencorë dhe mësimor-profesionalë të Universitetit të Tetovës nr. 01-4309/2 nga data 01.12.2021, kandidatja Jasmina Troshanska ka arritur gjithsej 75.26 pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

2 VEPRIMTARIA HULUMTESE-SHKENCORE

Opusi i pasur kërkimor-shkencor i kandidates Jasmina Troshanska nga zgjedhja e saj e fundit në titull në vitin 2020 është përqendruar kryesisht në sfidat që lidhen me çrregullimet nga spektri i autizmit. Përveç përqendrimit në ndërhyrjen e hershme, arsimin parashkollor dhe fillor, Jasmina Troshanska për herë të parë ka punuar në projekte kërkimore dhe është autore dhe bashkautore e punimeve që synojnë zbatimin e metodave bashkëkohore për punë me fëmijët me autizëm, siç është Analiza e Sjelljes së Aplikuar (ABA) dhe përdorimi i teknologjive moderne në edukimin e studentëve dhe trajtimin e fëmijëve me autizëm, realiteti virtual dhe platformat digjitale për të mësuar. Ajo është gjithashtu pjesë e një studimi të vetëm në Evropë dhe bashkautore e një punimi që fokusohet në gatishmërinë e mësuesve të edukatës fizike dhe shëndetësore për të punuar me nxënës me autizëm. Punimet janë publikuar në revista shkencore ndërkombëtare dhe aktivitetet e tjera janë prezantuar në konferenca ndërkombëtare.

2.1 Punime shkencore të botuara

1. Đorđević, M., Glumbić, N, Troshanska, J., Brojčin, B. (2025). A systematic review of individuals with autism in the healthcare system: Experiences of healthcare workers, individuals with autism, and their parents. *Hrvatska revija za rehabilitacijska istraživanja*, 61(1), 131-143. <https://doi.org/10.31299/hrri.61.1.8>
2. Troshanska, J., Sweeney, C., Toutountzidou, Z. (2025) Barriers to Independent Living for Young Adults with High-Functioning Autism in Europe, 13th InTraders International Conference on Social Sciences and Education Proceedings Book, International Balkan University, Skopje, N. Macedonia, (pp 181-196), e-ISBN: 978-625-98716-7-7.
3. Sheri Kingsdorf, Karel Pančocha, Kateryna Ivanova, Alexandra Faka & Jasmina Troshanska (21 Jun 2024): Investigating reported self-efficacy, attitudes, challenges, and knowledge of physical educators of autistic children across Europe, *International Journal of Developmental Disabilities*, DOI: 10.1080/20473869.2024.2366723
4. Troshanska J., Ramadani-Rasimi, T., Chichevska-Jovanova, N., Rashikj-Canevska, O., Healthcare access barriers for individuals with autism: The awareness of medical professionals, 10th International Conference: Research in Education and Rehabilitation Sciences, Conference Proceedings, Vol 1 (pp 53-66), Zagreb, 2024.
5. Rashikj-Canevska O., Chichevska Jovanova N., Troshanska J., Ramadani Rasimi T., Dimitrovska K., (2023). First reactions and future expectations of parents of children

- with developmental disabilities, 10th International Conference: Research in Education and Rehabilitation Sciences, Conference Proceedings, Vol 1 (pp 23-37), Zagreb, 2024
6. Troshanska, J., Ramadani Rasimi, T., & Maldenovska, A. (2023). Labour market inclusion of people with autism spectrum disorders: an analysis of the law. *30 years of special education and rehabilitation* (pp. 625-635). Ohrid: Faculty of Philosophy.
 7. Ramadani Rasimi, T., Agai, A., Troshanska, J., & Shafi, F. (2023). Challenges of hearing-impaired persons during COVID-19 in North Macedonia. *12th International Istanbul Congress on Humanities and Social Sciences* (pp. 733-741). Istanbul, Turkey: BZT Academy Publishing House.
 8. Troshanska, J., Agai, A., Memedi, B. (2023) Tonus, posturalnost i dvizenje kaj decata so narushuvanje od spektarot na autizam, International scientific-professional conference "Education of persons with disabilities-current situations and perspectives" Conference proceedings, Nacionalna I univerzitetska biblioteka Sv Kliment Ohridski, Skopje, RN Macedonia.
 9. Troshanska, J., Kingsdorf, Sh., Pankocha, K., Misoska, A. (2023) Readiness of physical education teachers to work with students with autism. Conference proceedings of VI International scientific conference, 30 years of special education and rehabilitation studies, 14-16 sept. 2023, Ohrid, RN Macedonia.
 10. Sheri Kingsdorf, Karel Pančocha, Jasmina Troshanska & Teuta Ramadani Rasimi (2022): Examining the perceptions of needs, services and abilities of Czech and North Macedonian caregivers of children with autism and trainers, *International Journal of Developmental Disabilities*, DOI: 10.1080/20473869.2022.2111970
 11. Troshanska J., Ramadani-Rasimi T., Kurtishi A., (2022): Assessing the needs and abilities of children with autism, *Proceeding book of the International Scientific Conference "Early Childhood Education and Care: Challenges and Perspectives"*, Fan S. Noli University of Korca, Albania, pg 92-104.
 12. Rashikj-Canevska O, Nikolovska A, Ramo-Akgun N, Troshanska J, Chichevska-Jovanova N. Thoughts, Attitudes and Experiences of Parents of Children with Disabilities in the Republic of North Macedonia About Comprehensive Sexuality Education. *Sex Disabil.* 2023;41(1):81-95. doi: 10.1007/s11195-022-09773-9. Epub 2023 Jan 9. PMID: 36684504; PMCID: PMC9838387.
 13. Preece D., Troshanska J., Lisak Shegota N., Lessner Lishtiakova I., Petkovska Nikolovska A., (2021): Autism Spectrum Disorder-Empowering and Supporting Teachers (ASD-EAST): Developing Teacher Education about ASD from Primary Teachers, *Proceeding Book of the International Conference on the occasion of the anniversary of the Faculty of Philosophy, Struga*, pg: 683-694
 14. Troshanska J., Ramadani Rasimi T., Memedi B., (2022): Behaviour in children with autism spectrum disorders, *Journal of Educational Sciences*, Beder University, June 2022, Vol.: 26 pg: 132-143, ISSN 2306-0557
 15. Troshanska J., Kingsdorf S., Panoca K., Nolcheva M., (2022): The Opinion of Mainstream School Teachers on the Content of the Autism Training: The A-class Project, *Abstract Book of the International Scientific Conference 75th Anniversary of the Institute of Pedagogy – Educational Challenges and Future Prospects*, Ohrid, pg: 89-90.

16. Ramadani Rasimi T., Memedi B., Troshanska J., Ademi D. (2021): Use of leisure time by hearing impaired persons based on gender and age, 6th International Istanbul scientific research congress proceedings book, ISBN: 978-605-74191-8-7, pg. 210-220.
17. Keskinova A., Troshanska J., Ramadani Rasimi T., Georgievski P. Accessible Museums., International scientific and practical conference Current Trends and Prospects of International Tourism (Skopje, 03.09.2021) Conference proceedings (27-35).
18. Ramadani-rasimi, T., Troshanska, J. Online podrška osobe sa poremećajima iz autističnog spektra, XII Međunarodna naučno-stručna konferencija "Unapređenje kvaliteta života dece i mladih, 25-27 jun 2021, Sunceveg Breg, Bugarska.

2.2 Pjesëmarrje në konferenca

1. **Ramadani-Rasimi, T., Troshanska, J.,** (2021): *Online support for children with autistic spectrum disorder* „Improving the quality of life of children and youth” 25th - 27th June 2021, Sunny Beach, Bulgaria.
2. **Ramadani-Rasimi, T., Memedi, B., Troshanska, J., Ademi, D.,** (2021): *Use of leisure time by hearing impaired persons based on gender and age*, 6th Istanbul Scientific Research Congress, Istanbul, Turkey.
3. **Keskinova, Angelka., Troshanska, Jasmina., Ramadani-Rasimi, Teuta., Memedi, Buniamin., Georgievski, Petar.,** (2021): *Accessible Museums*, International scientific and practical conference “Current trends and prospects of international tourism”, Skopje, RN Macedonia.
4. **Troshanska J., Ramadani-Rasimi T., Kurtishi A.,** (2022): *Assessing the needs and abilities of children with autism*, “International Scientific Conference “Early Childhood Education and Care: Challenges and Perspectives”, Fan S. Noli University of Korca, Albania
5. **Preece D., Troshanska J., Lisak Shegota N., Lessner Lishtiakova I., Petkovska Nikolovska A.,** (2021): *Autism Spectrum Disorder-Empowering and Supporting Teachers (ASD-EAST): Developing Teacher Education about ASD from Primary Teachers*, Proceeding Book of the International Conference on the occasion of the anniversary of the Faculty of Philosophy, Struga, R.N Macedonia.
6. **Troshanska J., Kingsdorf S., Panoca K., Nolcheva M.,** (2022): *The Opinion of Mainstream School Teachers on the Content of the Autism Training: The A-class Project*, Abstract Book of the International Scientific Conference 75th Anniversary of the Institute of Pedagogy – Educational Challenges and Future Prospects, Ohrid, RN Macedonia.
7. **Troshanska J.,** (2022) “*Positive Parenting*” 13th International Autism Europe Congress, Krakow, Poland.
8. **Troshanska J., Ramadani Rasimi T., Memedi B.,** (2022): *Behavior in children with autism spectrum disorders*, 8th International Conference on Educational and Social Sciences “New Perspectives in Education and Social Sciences” University of Beder, Tirana, Albania.
9. **Troshanska J., Agai A., Memedi B.** (2022): *Tonus, posture and movement in children with autism spectrum disorders*, International Scientific Conference Education of persons with disabilities current situations and perspectives, Skopje, RN Macedonia.

10. **Ramadani Rasimi, T., Agai, A., Troshanska, J., & Shafi, F. (2023).** *Challenges of hearing impaired persons during COVID 19 in North Macedonia. 12th International Istanbul Congress on Humanities and Social Sciences*, Istanbul, Turkey.
11. **Rashikj-Canevska, O., Chichevska-Jovanova, N., Troshanska J., Ramadani-Rasimi, T., Dimkovska, K. (2023):** *First reactions and future expectations of parents of children with development disabilities*, 10th International Conference: Research in Education and Rehabilitation Sciences ERFCO 2023, Zagreb, Croatia.
12. **Troshanska, J., Ramadani-Rasimi, T., Chichevska-Jovanova, N., Rashikj-Canevska, O. (2023):** *Healthcare access barrier for individuals with autism: The awareness of medical professional*. 10th International Conference: Research in Education and Rehabilitation Sciences ERFCO 2023, Zagreb, Croatia.
13. **Troshanska, J., Kingsdorf, Sh., Pankocha, K., Misoska, A. (2023)** Readiness of physical education teachers to work with students with autism. Conference proceedings of VI International scientific conference, 30 years special education and rehabilitation studies, Ohrid, RN Macedonia.
14. **Troshanska, J., Ramadani-Rasimi, T., Mladenovska, A. (2023)** Labour market inclusion of people with autism spectrum disorders: An analysis of the law. Conference proceedings of VI International scientific conference, 30 years special education and rehabilitation studies, Ohrid, RN Macedonia.
15. **Troshanska, J., Nikolovska, A., (2023),** *The role of digital games in the development of social skills in children with autism: Tips project*, 4th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy ISCFPH 2023, University of Tetova, R.N Macedonia.
16. **Troshanska, J., Kožárová J., Trellová I., Faka, A., Sweeney C., Jancec M., (2024)** *Early childhood behavior management training for preschool teachers through a digital game – Preschool ABA project*, Children and Childhoods Conference 2024, University of Suffolk, Ipswich, UK.
17. **Troshanska, J., Sweeney C., (2025)** *Barriers to Independent Living for Young Adults with High-Functioning Autism in Europe*. The 13th InTraders International Conference on Social Sciences and Education Skopje, North Macedonia.

2.3 Abstrakte të botuara (veçmas nga punimet):

1. **Troshanska J., Kingsdorf S., Panoca K., Nolcheva M., (2022):** The Opinion of Mainstream School Teachers on the Content of the Autism Training: The A-class Project, Abstract Book of the International Scientific Conference 75th Anniversary of the Institute of Pedagogy – Educational Challenges and Future Prospects, Ohrid, pg: 89-90.
2. **Troshanska, J., Sweeney, C., Toutountzidou, Z. (2025)** Barriers to Independent Living for Young Adults with High-Functioning Autism in Europe, 13th InTraders International Conference on Social Sciences and Education Abstract Book, International Balkan University, Skopje, N. Macedonia, e-ISBN: 978-625-98716-6-0 pg. 62.
3. **Rashikj-Canevska, O., Chichevska-Jovanova, N., Troshanska J., Ramadani-Rasimi, T., Dimkovska, K. (2023)** First reactions and future expectations of parents of children with development disabilities. Book of Abstracts, 10th International

Conference: Research in Education and Rehabilitation Sciences ERFCON 2023, May-5-7, 2023, Zagreb, Croatia.

4. **Troshanska, J., ramadani-Rasimi, T., Chichevska-Jovanova, N., Rashikj-Canevska, O.** (2023) Healthcare access barriers for individuals with autism: The awareness of medical professionals. Book of Abstracts, 10th International Conference: Research in Education and Rehabilitation Sciences ERFCON 2023, May-5-7, 2023, Zagreb, Croatia.

2.4 Prezantim me ftesë nga një universitet i huaj referent:

Troshanska, J. (2024), “*Building Partnerships with students*”, Student’s Ambassador Conference, University of Suffolk, UK.

2.5 Ligjëratë plenare në takim shkencor/profesional me pjesëmarrje ndërkombëtare

Troshanska J. (2025) *Innovative Technologies and VR in Special Education: Empowering University Students and Children with Special Needs*, Navigating the Future: Evolving Technologies for Visual Impairment-Opportunities, Challenges and Threats, ENVITER CONFERENCE, Skopje, RN Macedonia.

2.6 Udhëheqës i një projekti shkencor ndërkombëtar

“Parent Training for Inclusive STEAM Education of Children with Autism” (Erasmus + Nr: 2023-2-MK01-KA210-ADU-000174037)

2.7 Koordinator kombëtar i projekteve shkencore ndërkombëtare

- Sex Education for All: Training Service Providers to Support Autistic Individuals - SexEd4All
- ABA-VR: A Behaviour Management Training through Virtual Reality
- Houses4Autism: Supportive houses as a home for people with autism to build their independent living
- Early childhood behaviour management training for preschool teachers through a digital game
- An innovative Music Toolkit for children with autism to improve their emotional, motivational, interpersonal and social responsiveness
- An Autism and Behaviour Management training for P.E. school teachers (Perfect project)

- Labor Market Integration for People with autism

Bazuar në Rregulloren për kushtet dhe procedurat e veçanta për zgjedhje në tituj mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor-profesional në Universitetin e Tetovës nr. 01-4309/2 të datës 01.12.2021, kandidatja Jasmina Troshanska ka arritur gjithsej **178.9** pikë nga veprimtaria shkencoro-hulumtuese.

3 VEPRIMTARI PROFESIONALE-ZBATUESE

3.5 Autor (bashkautor) i udhëzuesit:

- Водич за практична примена на аугментативната и алтернативната комуникација во основното образование, Здружение за асистивна технологија „Отворете ги прозорците“, Скопје 2023.
- Udhëzues për zbatimin praktik të komunikimit augmentativ dhe alternativ në arsimin fillor, Shoqata për teknologji asistive ”Hapni dritaret”, Shkup, 2023.

3.2 Bashkautor i një udhëzuesi të botuar në kuadër ndërkombëtar në gjuhën angleze

- Trelova, I., Sweeney, C., Kozarova, J., Jancec, M., Troshanska, J., Faka, A., Sweeney, R. (2024). Behaviour management for children with autism, Teacher’s Handbook. University of Preshov, Preshov Press, 2024, ISBN 978-80-555-3326-1.

3.3 Përgatitja e materialeve për përdorim të brendshëm nga ligjëratat, si më poshtë:

1. Terapia kreative
2. Riedukimi i psikomotorikës
3. Intervenimi i hershëm dhe zhvillimi i fëmijëve me çrregullime të spektrit të autizimit

3.4 Recensues i udhëzuesit:

- Ruxandra Foloștină, Clare Gartland, Albina Khasanzyanova, and Ümit Çelen. *Partnering with Student Ambassadors to Create More Inclusive Universities Best Practices for Collaboration*, Routledge, ISBN: 978-1-032-95008-2 (hbk)

3.5 Pjesëmarrje aktive në "Java e veçantë studimore, hulumtuese dhe shkencore"

- "Java e veçantë studimore, hulumtuese dhe shkencore" 2022;
- "Java e veçantë studimore, hulumtuese dhe shkencore" 2023;
- "Java e veçantë studimore, hulumtuese dhe shkencore" 2024.

3.6 Pjesëmarrje aktive dhe kontribut në organizimin e ngjarjeve në universitet

- "2 Prill – Dita Botërore e Ndërgjegjësimit për Autizmin" 2022
- "2 Prill – Dita Botërore e Ndërgjegjësimit për Autizmin" 2023
- "2 Prill – Dita Botërore e Ndërgjegjësimit për Autizmin" 2024
- "3 Dhjetor – Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara" 2022
- "3 Dhjetor – Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara" 2023
- "3 Dhjetor – Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara" 2024

Bazuar në Rregulloren për kushtet dhe procedurën e veçantë për zgjedhje në titujt mësimor-shkencorë, shkencorë dhe mësimor-profesionalë në Universitetin e Tetovës nr. 01-4309/2 të datës 01.12.2021, kandidatja Jasmina Troshanska ka arritur gjithsej **13.5 pikë** nga veprimtaria profesionale-aplikuese.

4 AKTIVITETE ME INTERES TË GJERË

4.1 Anëtar i redaksisë së një reviste shkencore/profesionale ndërkombëtare:

- Anëtare e këshillit organizativ të tubimit shkencor/profesional ndërkombëtar:
Konferenca e Katërt Ndërkombëtare e Fakultetit Pedagogjik, 15-17 nëntor 2023.
- Anëtare e këshillit organizativ të tubimit shkencor/profesional ndërkombëtar:
Konferenca e Pestë Ndërkombëtare e Fakultetit Pedagogjik, 6-8 nëntor 2024.

4.2 Anëtar i trupës organizuese për organizimin e:

- “2 Prill – Dita Botërore e Ndërgjegjësimit për Autizmin” 2022
- “2 Prill – Dita Botërore e Ndërgjegjësimit për Autizmin” 2023
- “2 Prill – Dita Botërore e Ndërgjegjësimit për Autizmin” 2024
- “3 Dhjetor – Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara” 2022
- “3 Dhjetor – Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara” 2023
- “3 Dhjetor – Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara” 2024

4.3 Anëtare e komisionit të fakultetit

- Anëtare e komisionit për përgatitjen e programit studimor të Edukimit Special dhe Rehabilitimit në ciklin e dytë të studimeve. Vendim nr: 24-29/1 i datës 25.01.2021.

Bazuar në Rregulloren për kushtet dhe procedurën e veçantë për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor-profesional në Universitetin e Tetovës nr. 01-4309/2 të datës 01.12.2021, kandidatja Jasmina Troshanska ka arritur gjithsej **8.5 pikë** nga aktivitetet me interes më të gjerë.

PËRFUNDIM DHE PROPOZIM


Bazuar në dokumentacionin e përgjithshëm dhe njohjen personale të kandidatës, Komisioni i Recensues vlerëson pozitivisht veprimtarinë shkencore-mësimore, veprimtarinë shkencore-hulumtuese, veprimtarinë profesionale-aplikuese dhe veprimtarinë me interes më të gjerë shoqëror të doc. dr. Jasmina Troshanska. Komisioni vlerëson se doc. dr. Jasmina Troshanska i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Rregulloren për kushtet dhe procedurën e veçantë për zgjedhje në titujt mësimor-shkencorë, shkencorë, mësimor-profesionalë dhe bashkëpunëtorë në

Universitetin e Tetovës (nr. 01-4309/2, data 01.12.2021). Interesi dhe aftësitë cilësore në fushën ku aplikon i mundësuan kandidatës, me 276.16 pikë të fituara, të tejkalojë ndjeshëm numrin minimal të nevojshëm të pikëve. Këto arritje dëshmojnë se kandidati i plotëson të gjitha kushtet për të zgjedhur në thirrjen profesor inordinar në fushën shkencore-mësimore të Edukimit Special dhe Rehabilitimit (5.03.00.10).


Sipas asaj që u tha më lartë, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë që ti propozojë Këshillit mësimor – shkencor të Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës, që doc.dr. Jasmina Troshanska të zgjidhet në thirrjen mësimore shkencore **profesor inordinar** në fushën mësimore-shkencore *Edukim special edhe rehabilitim* (5.03.00.10).

Komisioni i recensueses:

1. Prof. dr. Bunjamin Memedi (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Tetovës,



2. Prof. dr. Lulzim Mehmedi (anëtar) – profesor inordinar në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Tetovës,



3. Prof. dr. Arita Agai (anëtare) - profesor inordinar në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Tetovës,



Jasmina Troshanska të zgjidhet në thirrjen mësimore shkencore **profesor inordinar** në fushën mësimore-shkencore *Edukim special edhe rehabilitim* (5.03.00.10).

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË, MËSIMORË-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTORË

Kandidati: Jasmina Troshanska

Institucioni: Fakulteti Pedagogjik – UT, Tetovë

Fusha shkencore: – Edukim Special dhe Rehabilitim (5.03.00.10)

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TUTULL MËSIMOR-SHKENCOR – PROFESOR I ASOCIUAR/ TUTULL SHKENCOR – BASHKËPUNËTOR I LARTË SHKENCOR

Nr. Rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1.	Suksesi mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë, për secilin cikël veçmas, përkatësisht ka arritur sukses mesatar së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara në ciklin e parë dhe të dytë. Suksesi mesatar në ciklin e parë është: 8,30 Suksesi mesatar në ciklin e dytë është: 9,71	Po
2.	Titulli shkencor – doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet Emri i sferës: Edukim dhe Arsim Emri i sferës: Edukim Special dhe Rehabilitim (5.03.00.10)	Po
3.	Të publikuara së paku pesë punime shkencore të recensuara në publikime shkencore referente në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	Po

Nr. Rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensionit dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër e revistave të cilën do ta përcaktojë Këshilli kombëtar për arsimin e lartë 1. Emri i revistës shkencore: International Journal of Developmental Disabilities 2. Emri i bazës elektronike të të dhënave të revistës: Scopus, Web of Science (ESCI) Index 1.4 3. Emri i punimit: Examining the perceptions of needs, services and abilities of Czech and North Macedonian caregivers of children with autism and trainers 4. Viti i botimit:2022 ----- 1. Emri i revistës shkencore: International Journal of Developmental Disabilities 2. Emri i bazës elektronike të të dhënave të revistës: Scopus, Web of Science (ESCI) Index 1.4. 3. Emri i punimit: Investigating reported self-efficacy, attitudes, challenges, and knowledge of physical educators of autistic children across Europe 4. Viti i botimit:2024 ----- 1. Emri i revistës shkencore: <i>Hrvatska revija za rehabilitacijska istraživanja</i> 2. Emri i bazës elektronike të të dhënave të revistës: Scopus, EBSCO. 3. Emri i punimit: A systematic review of individuals with autism in the healthcare system: Experiences of healthcare workers, individuals with autism, and their parents 4. Viti i botimit:2025 ----- 1. Emri i revistës shkencore: <i>Springer</i> 2. Emri i bazës elektronike të të dhënave të revistës: Web of Science Index 1.5; Scopus. 3. Emri i punimit: Thoughts, Attitudes and Experiences of Parents of Children with Disabilities in the Republic of	Po Po

Nr. Rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
	North Macedonia About Comprehensive Sexuality Education 4. Viti i botimit: 2023 ----- 1. Emri i revistës shkencore: Journal of Educational Sciences 2. Emri i bazës elektronike të të dhënave të revistës: Google Scholar, ROAD, OpenAIRE, Index Copernicus, Europub. 3. Emri i punimit: Behaviour in children with autism spectrum disorders 4. Viti i botimit: 2022 ----- 1. Emri i revistës shkencore: 13th InTraders International Conference on Social Sciences and Education Proceedings Book 2. Emri i bazës elektronike të të dhënave të revistës: EBSCO / ProQuest. 3. Emri i punimit: Barriers to Independent Living for Young Adults with High-Functioning Autism in Europe 4. Viti i botimit: 2025	Po
